



Mbrojtja është një aspekt thelbësor i gjykimeve të drejta. Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) garantojnë gjykim të drejtë, proces të bazuar në ligj dhe standardet më të larta të mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat që paraqiten para tyre. E drejta e mbrojtjes së efektshme garantohet prej një avokati që përmbush kriteret për ushtrimin e profesionit para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

#### TË DREJTAT E TË DYSHUARVE DHE TË AKUZUARVE

Një ndër të drejtat më të rëndësishme të të dyshuarve dhe të akuzuarve para Dhomave të Specializuara të Kosovës është e drejta për mbrojtës që duhet të jenë pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar.

Gjithashtu, të dyshuarit dhe të akuzuarit kanë të drejtë t'u caktohet një mbrojtës, në qoftë se nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për pagesën e mbrojtjes dhe është konstatuar se janë të varfër.

#### PËRFAQËSIMI

Në Dhomat e Specializuara të Kosovës, përfaqësimi i një të dyshuari apo të akuzuari prej një mbrojtësi është i detyrueshëm:

- në seancat në lidhje me paraburgimin dhe kur një i dyshuar apo i akuzuar mbahet në paraburgim;
- që nga ngritja e aktakuzës, në qoftë se akuzat kanë të bëjnë me një vepër penale të dënueshme me të paktën dhjetë vjet burgim; dhe

*Shënim:* Ka dallim midis mbrojtësit për të dyshuar ose të akuzuar nga njëra anë, dhe Zyrës së Mbrojtjes, nga ana tjetër.

Mbrojtës janë avokatë të pavarur që përfaqësojnë dhe mbrojnë të dyshuar ose të akuzuar në procedura penale para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

- në të gjitha rastet kur një i akuzuar kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë në lidhje me një vepër penale të dënueshme me një ose më shumë vjet burgim.

#### KRITERET PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT

Të dyshuarit dhe të akuzuarit kanë të drejtë të zgjedhin mbrojtës nga Lista e Mbrojtësve të Specializuar. Për këtë arsye, avokatët që duan të punojnë si mbrojtës para Dhomave të Specializuara të Kosovës, duhet të pranohen në Listën e Mbrojtësve. Listën e Mbrojtësve e administron Zyra e Mbrojtjes e Zyrës Administrative të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Avokatët që duan të pranohen në Listën e Mbrojtësve duhet t'i dërgojnë Zyrës së Mbrojtjes një kërkesë për pranim ([defenceoffice@scp-ks.org](mailto:defenceoffice@scp-ks.org)).

Zyra e Mbrojtjes kryen verifikimin e kërkesave për pranim në lidhje me përmbushjen e kriterëve të parashtruara në Direktivën për Mbrojtësit. (një shpjegim të shkurtër të procedurës së pranimit e gjeni në faqen e pasme të këtij fletinformacioni)

Zyra e Mbrojtjes është njësi e Zyrës Administrative që mbështet procedurat gjyqësore të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ndër të tjera përmes administrimit të Listës së Mbrojtësve dhe të sistemit të ndihmës juridike. Zyra e Mbrojtjes nuk u ofron këshillim juridik individual të dyshuarve ose të akuzuarve.

#### KONTAKT

## NDIHMJA JURIDIKE

Sistemi i ndihmës juridike i DHSK-së mishëron praktikat më të mira të standardeve të ndihmës juridike, duke garantuar përputhshmëri me parimet e procesit ligjor të drejtë, ndërsa siguron me transparencë miradministrimin financiar të skemës së ndihmës juridike.

Çdo të dyshuari ose të akuzuari para DHSK-së, i cili demonstroi se nuk mund të paguajë për mbrojtjen e vet, pjesërisht ose plotësisht, i sigurohet ndihmë juridike për të paguar mbrojtësin që e zgjedh vetë, i cili plotëson kriteret e pranimit në Listën e Mbrojtësve të DHSK-së.

Kur një person kërkon ndihmë juridike, ai/ajo duhet të dorëzojë Formularin e Deklarimit të Mjeteve Financiare, të plotësuar.

Zyra e Mbrojtjes kryen një verifikim të kujdesshëm të mjeteve financiare të personit që kërkon ndihmë juridike për të vërtetuar nëse ai person mund të paguajë pjesërisht ose plotësisht për mbrojtjen e vet.

Në rast se personi nuk mund të paguajë, Administratorja miraton ndihmën juridike. Nëse parashtruesi i kërkesës për ndihmë juridike nuk bashkëpunon ose jep informacion të rremë, kërkesa për ndihmë juridike refuzohet. Honorari i ndihmës juridike i paguhet drejtpërdrejt avokatit mbrojtës për të mbuluar shpërblimin e avokatit dhe të anëtarëve të tjerë të ekipit të tij.

Rregullorja e Ndhmës Juridike përcakton tarifatat maksimale të llogaritura sipas nivelit të kompleksitetit të çështjes dhe fazave të procedurave. Për më tepër, shpenzimet që mund të dalin nga kryerja e hetimeve dhe/ose përkthimet do të paguheshin pas dorëzimit të faturave, deri në një shumë maksimale të përcaktuar në Rregullore.

Rregullorja e Ndhmës Juridike për DHSK-në, si edhe informacione të detajuara mbi mënyrën se si bëhet kërkesa për ndihmë juridike mund të gjenden në faqen e internetit të DHSK-së në të tri gjuhët zyrtare të Gjykatës, në : <https://www.scp-ks.org/sq/perfaqesimi-juridik/ndihma-juridike>.

## LISTA E MBROJTËSVE

Më 6 nëntor 2017, Administratorja nxori Direktivën për Mbrojtësit, pas miratimit prej Kryetares së Dhomave të Specializuara të Kosovës në këshillim me gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Kjo Direktivë rregullon kriteret e pranueshmërisë për përfshirje në Listën e Mbrojtësve, detyrimet në vijimësi të mbrojtësve të pranuar në Listën e Mbrojtësve, si dhe modalitetet e vetëtërheqjes dhe të përjashtimit nga Lista e Mbrojtësve. Zyra e Mbrojtjes përpilon dhe administron një listë mbrojtësish që plotësojnë kriteret e përfaqësimit të një të dyshuari ose të akuzuari para Dhomave të Specializuara ("Lista e Mbrojtësve të Specializuar").

Vetëm mbrojtësit e pranuar në Listë përbushin kriteret për përfaqësimin e të dyshuarve ose të akuzuarve para Dhomave të Specializuara.

Kriteret për praninë në Listën e Mbrojtësve janë:

- kompetencë dhe përvojë e dëshmuar në fushën e së drejtës dhe procedurës penale vendore dhe/ose në fushën e së drejtës dhe procedurës penale ndërkombëtare;
- të paktën dhjetë (10) vjet dhe si bashkëmbrojtës, të paktën shtatë (7) vjet përvojë të dëshmuar përkatëse, goftë si avokat i mbrojtjes apo i viktimave, si prokuror, gjykatës, ose në një funksion të ngjashëm në procese penale;

- gjatë gjithë kohës që është i përfshirë në Listën e Mbrojtësve, kërkuesi vazhdon të jetë anëtar i shoqatës së avokatëve ose i një institucioni të ngjashëm të vendit të tij, ose gjykatës apo prokuror në varësi të një autoriteti mbikëqyrës;
- aftësi të komunikimit me shkrim dhe me gojë në një nga gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara (shqip, serbisht, anglisht);
- kërkuesi nuk është shpallur fajtor në procese penale, ose ndryshe ndaj tij nuk janë marrë masa disiplinore në procedime disiplinore përkatëse kundër tij në ndonjë forum shtetëror ose ndërkombëtar;
- kërkuesi nuk ka pasur sjellje të pandershme ose diskredituese për një mbrojtës, në dëm të administrimit të drejtësisë, ose që ka gjasë të pakësojë besimin e publikut në Dhomat e Specializuara, ose në administrimin e drejtësisë, ose që diskrediton emrin e Dhomave të Specializuara.

Nëse kundër kërkuetit janë në kryerje e sipër procedime, hetime ose verifikime penale, disiplinore ose të tjera, vendimi mbi praninë shtyhet deri në daljen e vendimit të formës së prerë prej procedurave të përmendura më parë.

## SI BËHET

Formulari i kërkesës dhe Udhëzimet gjenden në adresën e mëposhtme në Internet:

[www.scp-ks.org/sq/dhomat-e-specializuara/mbrojtja](http://www.scp-ks.org/sq/dhomat-e-specializuara/mbrojtja)